

SHFMU "Ernest Koliqi" Babush i M.

Më datën: 13.08.2021

Nga drejtori: Idriz Sopa

HISTORIKU I SHKOLLËS

Fillet e para të arsimit në fshatin tonë datojnë që nga viti 1926. Në këtë kohë, mësimi është zhvilluar në gjuhën turke në gjaminë e fshatit me mësuesin; Mulla Sahiti. Pas mbarimit të luftës, nxënësit e fshatit tonë, mësimet i vijonin në fshatin fqinjë Llugaxhi.

Pas tri vite pune aty, mësimi filloi të zhvillohej sërish në fshat Babush me mësuesin e parë Tefik Lohaj nga fshati Mirash.

Në vitin 1956, shkolla fillore në fshatin Babush formoi paralelen e ndarë nga shkolla fillore Zenel Hajdini në Gadime dhe numëronte rreth 120 nxënës. Më pas ky numër më 1958-'59 u dyfishua, dhe numëronte rreth 240 nxënës. Kështu u bë shkollë katër klasëshe me dy paralele me mësuesit: Jakup Reqicën, Ismail Marevcin, Nazmi Hajrizin dhe Fehmi Bellainën.

Rritja e numrit të nxënësve ka bërë që përfundimisht pas një periudhe të gjatë kohore të ndërtohet një objekt i ri shkollor me vetëkontributin e qytetarëve të fshatit dhe me ndihmën e organeve komunale të asaj kohe.

Ndërtimi filloi në vitin 1984, dhe kështu më 17 nëntor të vitit 1985, bëhet përrurimi i shkollës ekzistuese.

Më datë: 10.04.1997 kjo shkollë pavaresohet nga ajo e fshatit Gadime, me vendimin e MASHT- it dhe pagëzohet me emrin "Ernest Koliqi". Kjo shkollë ka 10 dhoma mësimi, një zyrë të mësimdhënësve, një kabinet shkolle, zyrën e drejtorit, dhomën e punëtorëve teknikë si dhe dy bodrume të cilat shfrytëzohen për lëndë djegëse.

Në vitin 2012 ndërtohet paralelja e ndarë në Gadime të ulët e cila ka 5 dhoma mësimi, dhoma për mësimdhënës dhe pjesën shtesë për nxemje qendrore.

Mësimi në shkollën tonë zhvillohet në një ndërrim dhe atë: cikli i lartë (6-9) mësojnë në shkollën amë në Babush, ndërsa cikli i ulët (1-5) mësojnë në paralelen e ndarë në Gadime të ulët.

Sot shkolla punon në objekte të rinuara në kushte të mira pune dhe me një kuadër të kualifikuar për mësimin klasor, si dhe për mësimin lëndor. Numri i mësimdhënësve në këtë shkollë është 26, stafi teknik i përbërë nga 5 punëtorë si dhe drejtori i shkollës.